



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 959/3 Prot.

Tiranë, më 16/04/2012

Lënda: Rekomandim për “Universiteti Bujqësor” Tiranë.

REKOMANDIM
Nr. 06, datë 16/04/2012

Mbështetur në ligjin nr.9887,datë,10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, pas shqyrtimit të ankesës së RTV “Ora News” lidhur me kërkesën për lëshimin e autorizimit në zbatim të ligjit nr. 9367 datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, nga disa pedagogë të “Universitetit Bujqësor” Tiranë

KONSTATOVA

Pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale është paraqitur një ankese nga ana e RTV “Ora News” lidhur me kërkesën që i është drejtuar disa pedagogëve të “Universitetit Bujqësor” Tiranë, për lëshimin e autorizimit në zbatim të ligjit nr. 9367 datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Ankesa është shqyrtuar nga ana e Drejtorise të Hetim-Inspektimit,janë marrë informacionet e kërkuara me shkresën e datës 10.04.2012 shoqëruar me dokumentet e kërkuara. Është shqyrtuar i gjithë dokumentacioni i ardhur nën vështrimin e zbatimit te kërkesave të ligjit nr, 9887 datë, 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.

Kontrolluesi “Universitetit Bujqësor” Tiranë ka hartuar rregulloren në zbatim të ligji nr. 9367 datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike në të cilën ka përcaktuar procedurat që zbatohen për plotësimin dhe administrimin e “autorizimit” si kërkesë e ligji nr. 9367 datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, si dhe strukturën përgjegjëse të ngarkuar për zbatimin e kësaj procedure.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi dokumentet e administruara vëren se:

- 1) Kontrolluesi “Universiteti Bujqësor” Tiranë nuk ka plotësuar detyrimin për informim për subjektet e të dhënave personale.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale është një detyrim i rëndësishëm i parashikuar në nenin 18 të ligjit nr, 9887 datë, 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”. Pedagoget si subjekte të të dhënave personale duhet të dinë se çfarë bëhet me të dhënat personale të tyre, qëllimet për të cilat ato mblidhen nga kontrolluesi, mënyrën e përpunimit, ruajtjes dhe përhapjes së të dhënave të tyre, ato duhet të dinë se sa të sigurt do të jenë të dhënat të cilat tyre u mblidhen nga institucioni kontrollues.

Informimi i subjekteve të të dhënave personale duhet të bëhet gjatë të gjitha fazave të zbatimit të ligjit i tillë që subjektet e të dhënave të jenë të qartë se të dhënat e tyre sensitive lidhur me shëndetin, gjendjen gjyqësore, besimin fetar, kombësinë etj, nuk janë objekt i këtij autorizimi. Informimi i subjekteve të të dhënave personale duhet të bëhet gjatë të gjitha fazave të procedurave të lidhura me zbatimin e dispozitave për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike. Subjektet e të dhënave personale duhet të informohen se si do të trajtohet dokumentacioni dhe të dhënat që mblidhen gjatë procedurave të identifikimit dhe regjistrimit të interesave private të tyre në zbatim të ligjit nr, 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”

Informimi i pedagogëve duhet të realizohet në mënyrë të plotë dhe të hollësishme gjatë procedurave të plotësimin nga ana tyre të autorizimit që në momentin e mbledhjes së këtyre autorizimeve.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur neni 18 pika 1 e ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, ... “Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet ta informojë subjektin e këtyre të dhënave. Në këtë informacion duhet të përcaktohen kategoritë e të dhënave personale, që do të përpunohen, qëllimi i përpunimit, emri dhe adresa e kontrolluesit dhe çdo informacion tjetër i nevojshëm, për të garantuar përpunimin e drejtë të të dhënave personale”.

- 2) Kontrolluesi “Universiteti Bujqësor” Tiranë duhet të trajtojë në mënyrë konfidenciale dhe të sigurtë të gjithë informacionin si dhe të dhënat personale që mblidhen për pedagogët gjatë procesit të lëshimit të autorizimit.

Kontrolluesi duhet të zbatojë kërkesat e nenit 27 të ligjit nr, 9887 datë, 10/03/2008 “ Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, duke i mbajtur autorizimet dhe të gjitha dokumentet që lidhen me zbatimin e ligjit nr, 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” në dosje të veçanta, ambiente të sigurtë dhe për aq kohë për të cilën ato i shërbejnë qëllimit për të cilin janë mbledhur. Aksesi në këto dosje duhet të jetë i kufizuar, duhet të zbatohet me përpikmëri procedura e vendosur në rregulloren përkatëse.

Kontrolluesi duhet të përcaktojë subjektet drejt të cilave ka përhapje të të dhënave personale si dhe kohën e ruajtjes së dokumenteve që mblidhen dhe përpunohen gjatë procedurave të cilat kanë lidhje me konfliktin e interesit. Kontrolluesi duke vendosur masat e sigurisë për ruajtjen e të dhënave personale që mblidhen gjatë këtij procesi duhet të përcaktojë mekanizma për kontrollin e aksesit, identifikimin e saktë të çdo përdoruesi të të dhënave, respektimin e konfidencialitetit, përcaktimin në mënyrë të qartë të detyrave dhe përgjegjësisë të stafit, procedurave të përpunimit, sistemit, arkivimit etj. Rregulla të tilla janë të domosdoshme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave (pedagogëve) gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

- 3) Te gjitha dokumentet që lidhen me procedurat e zbatimit të ligjit nr. 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” duhet të mbahen vetëm në dosje të veçanta, raftë të posaçëm të siguruara me kyç. Duhet të caktohen persona përgjegjës të cilët në çdo rast verifikimi të mundshëm të jenë plotësisht të informuar mbi rregullat që duhet të zbatohen në përputhje me ligjin nr. 9887, datë, 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe ligjin nr. 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Në këto kushte vlerësoj se është shkelur neni 27 pika 1 e ligjit nr. 9887, datë, 10.3.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”... *“Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”*

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë, 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative:

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 18 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të bëhet informimi i plotë i subjekteve të të dhënave personale “pedagogë”, për qëllimin e përpunimit të të dhënave personale, si dhe çdo informacion i nevojshëm që garanton përpunimin e drejtë të të dhënave personale gjatë procesit të plotësisht të autorizimit si detyrim ligjor nga ligji nr. 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
2. Në zbatim të nenit 27 pika 1, të ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, të hartohet një Rregullore e veçantë lidhur me konfidencialitetin dhe sigurinë e të dhënave personale që përpunohen nga kontrolluesi “Universiteti Bujqësor” Tiranë, ku të përfshihen dhe rregulla lidhur me të dhënat personale që do të zbatohen për mbledhjen, përpunimin, kohën e ruajtjes, ambientet, si dhe personin/personat e ngarkuar, në të gjitha fazat e procesit të plotësisht të autorizimit, si dhe procedurave të identifikimit të konfliktit të interesit të parashikuara nga ligji nr. 9367, datë 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Për hartimin e kësaj Rregulloreje mund të asistoheni nga Zyra e Komisionerit.
3. Në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 9887 datë, 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” të gjitha dokumentet që lidhen me procedurat e zbatimit të ligjit nr. 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të mbahen në dosje të veçanta të veçuara nga dosjet që mbahen për punonjësit, si dhe të mbahen në raftë të posaçëm të siguruara me kyç. Në këtë dokumentacion të kenë akses vetëm personat përgjegjës të cilët në çdo rast verifikimi të mundshëm të veprojnë plotësisht në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008

“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe ligjin nr, 9367 datë, 07/04/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

4. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm që ju ngarkon ligji, të kryhet brenda një afati kohor prej 45 (dyzetepesë) ditësh.
5. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas neni 30, pika 2, të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale, sipas të cilit ”Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

FLORA CABEJ (POGAÇE)

